



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 4807/prot.
14

Tiranë, më 16.10.2025

Lënda: Dërgim dokumentacioni

GJYKATËS KUSHTETUESE
Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr.28 (E) 2025 Regj.Them, datë 15.10.2025, ju dërgojmë bashkëlidhur kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentacionit të paraqitur pranë Këshillit të Ministrave, në bazë të të cilit është miratuar vendimi nr.539, datë 25.9.2025, i Këshillit të Ministrave, “Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliqj”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Engjëll AGAÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
DREJTORIA GJYQËSORE DHE E DOKUMENTACIONIT

Nr. 28 (E) 2025 Regj.Them.

Tiranë, më 13.10.2025

URGJENT

Lënda: Kërkesë për dokumentacion.

Drejtuar: Këshillit të Ministrave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

TIRANË

Në vijim të komunikimeve për çështjen me kërkesues Erion Veliaj dhe objekt: "Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 25.09.2025 "Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë". Shfuqizimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 350, datë 1.10.2025 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore", për pjesën që cakton datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë Tiranë, si i papajtueshëm me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 115 të Kushtetutës. Pezullimi i efekteve juridike të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 350, datë 01.10.2025 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për Kryetar Bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore", për pjesën që cakton datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë Tiranë, në zbatim të efekteve pezulluese që paragrafi 2 dhe 3 i nenit 115 i Kushtetutës i njeh ankimit kushtetues të Kryetarit të Bashkisë, ndaj vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese", bazuar në nenin 42 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për nevoja të shqyrtimit kushtetues, lutemi të na vendosni në dispozicion brenda

datës 16.10.2025, ora 14:00, të gjithë praktikën në lidhje me procedurën e ndjekur për shkarkimin nga detyra të kërkuarit Erion Veliaj.

Ju faleminderit,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Eugen PAPANDILE

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Drejtorë e Drejtorisë Gjyqësore dhe Dokumentacionit

Edmira BABAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 539, datë 25.9.2025

KRYEMINISTRIA
Arkivë Protokolli
Nr. 18 prot. Dt. 16.10.2025
Vërtetohet njësisë me originalin
Nëpunësi:
Nazmi Dragoj
(nënshkrimi)
Nr. fletë: 12

P Ë R

**SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT
TË BASHKISË TIRANË, Z. ERION VELIAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 62, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Z. Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë Tiranë, shkarkohet nga kjo detyrë, me propozimin e Këshillit Bashkiak Tiranë, miratuar me vendimin nr.69, datë 23.9.2025.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I SHTEBIT PËR
PUSHTETIN VENDOR

ERVIN DEMO

NR.PROT. 4612/2
DATE 25.9.2025

MINISTRIT TË SHETIT PËR PUSHTETIN VENDOR
MINISTRISË SË DREJTËSISË
BASHKISË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



KRYEMINISTRIA	
Arkivë Protokolli	
Nr. _____	prot.Dt. _____
Vërtetohet njëzia me origjinalin	
Nëpunësi: _____	
(nenshkrimi) _____	
Nr.fletë: _____	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT TIRANË

Nr. 12.23 Prot.
Lënda: Njoftim.

Tiranë, më 24. 9. 2025

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Në mbështetje të nenit 61, pika 3 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar ku citohet se:

"Për rastet e përfundimit të mandatit të kryetarit përpara afatit, këshilli bashkiak njofton Këshillin e Ministrave nëpërmjet prefektit",

Po ju përcjellim konfirmimin e vendimit nr.69, datë 23.09.2025 "Për propozimin e shkarkimit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë z.Erion Veliq" të institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë.

Bashkëlidhur do të gjeni një kopje të konfirmimit dhe vendimit nr.69, datë 23.09.2025 të Këshillit Bashkiak Tiranë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKT

AFRIM QËNDRO

KRYEMINISTRIA Arkivë Protokoll	
Nr. _____	prot.Dt. _____
Vërtetohet njësisë me origjinalin	
Nëpunësi: _____	
(nënshkrimi)	
Nr. letë: _____	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT TIRANË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 123/ Prot.

Tiranë, më 24.9.2025

Lënda: Verifikim ligjshmërie.

KËSHILLIT TË BASHKISË TIRANË

Bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar dhe ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi Vendimin nr. 69, datë 23.09.2025 të Këshillit të Bashkisë Tiranë.

Vendimi nr. 69, datë 23.09.2025 "Për propozimin e shkarkimit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Z. Erion Veliqaj".

Konfirmohet referuar nenit 61, shkronja "ç" dhe nenit 62, shkronja "c" të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKT

AFRIM QËNDRO



KRYEMINISTRIA
Arkivë Protokoli
Nr. _____ prot.Dt. _____
Vërtetohet njësia me origjinalin
Nëpunësi: _____
(nënshkrim)
Nr.fletë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 32662 prot.

Tiranë, më 24.09.2025

VENDIM

Nr. 69, datë 23.09.2025

"PËR
PROPOZIMIN PËR SHKARKIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË TIRANË
Z. ERION VELIAJ"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 61 shkronja "ç", neni 62 shkronja "c", me propozimin e një grupi këshilltarësh, Këshilli i Bashkisë Tiranë, në mbledhjen e datës 23.09.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për shkarkimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj.
2. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë, sipas përcaktimeve të Ligjit 135/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 61, pika 3.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR

MEGJITHO

KRYEMINISTRIA	
Arkivë Protokolli	
Nr.	prot.Dt.
Vërtetohet njësia me origjinalin	
Nëpunësi:	
(nënshkrimi)	
Nr.fletë:	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

Nr. 4612 Prot

Tiranë, më 24. 08. 2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim e miratim një projektvendim

KËSHILLIT TË MINISTRAVE


Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim e miratim projektvendimin "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj", së bashku me relacionin shoqërues.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTËR I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

ERVIN DEMO



KRYEMINISTRIA	
Arkivë Protokolli	
Nr. _____	prot. Dt. _____
Vërtetohet njëzia me origjinalin	
Nëpunësi:	
(nenshkrimi) 	
Nr. fletë: _____	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË BASHKISË TIRANË,
Z. ERION VELIAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 62, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, shkarkohet nga kjo detyrë, me propozim të Këshillit Bashkiak Tiranë, miratuar me vendimin nr.69, datë 23.9.2025.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

KRYEMINISTRIA	
Arkivë Protokolli	
Nr. _____	prot.Dt. _____
Vërtetohet njëzia me origjinalin	
Nëpunësi:	
(nënshkrimi)	
Nr.fletë:	

RELACION
PËR

KRYEMINISTRIA Arkivë Protokolli	
Nr. _____	prot.Dt. _____
Vërtetohet njësia me origjinalin	
Nëpunësi: _____	
(nënshkrimi) _____	
Nr.fletë: _____	

**PROJEKTVENDIMIN “PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË
KRYETARIT TË BASHKISË TIRANË, Z. ERION VELIAJ”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Projektvendimi “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj” është hartuar mbështetur në propozimin e Këshillit Bashkiak Tiranë, të miratuar me vendimin nr.69, datë 23.9.2025.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2025.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Këshilli bashkiak ka marrë vendimin nr.69, datë 23.9.2025 në rrethanat kur Kryetari i Bashkisë Tiranë ndodhet në pamundësinë fizike për t’u paraqitur në detyrë prej datës 10 shkurt 2025, për shkak të vendosjes ndaj tij të masës shtrënguese të sigurimit personal.

**IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE
HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E
NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të shkronjës “c”, të nenit 62, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT
COMMUNAUTAIRE TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKTET
NORMATIVE)

KRYEMINISTRIA Arkivë Protokolli	
Nr.	prot.Dt.
Vërtetohet njësisht me origjinalin	
Nënshkrimi	
Nr.fletë:	

Projektvendimi nuk ka përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi parashikon shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, mbështetur në propozimin e Këshillit Bashkiak Tiranë, të miratuar me vendimin nr.69, datë 23.9.2025.

Këshilli bashkiak ka marrë vendimin nr.69, datë 23.9.2025 në rrethanat kur Kryetari i Bashkisë Tiranë ndodhet në pamundësinë fizike për t'u paraqitur në detyrë prej datës 10 shkurt 2025, për shkak të vendosjes ndaj tij të masës shtrënguese të sigurimit personal.

Pavarësisht kërkesave të përsëritura procedurale, gjykata ka lënë në fuqi masën arrest me burg për kryetarin e Bashkisë Tiranë dhe nuk ka pranuar heqjen e masës, apo zëvendësimin me një masë tjetër shtrënguese që do të mundësonte paraqitjen në detyrë. Këshilli Bashkiak Tiranë ka konstatuar se mosparaqitja në detyrë, në rrethanat e sipërcituara dhe për një periudhë më të gjatë se tre muaj, përbën shkak ligjor për të propozuar shkarkimin e Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në shkronjën "c", të nenit 62, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Fakti juridik i pamundësisë së paraqitjes në detyrë është fakt publik dhe vërtetësia e tij nuk mund të vihet në dyshim. Po kështu nuk mund të vihet në dyshim shqetësimi i këshilltarëve bashkiakë për dëmin e rëndë që i shkakton nevojave të qeverisjes së kryeqytetit dhe interesit të qytetarëve të Tiranës, mungesa e zgjatur në detyrë e Kryetarit të Bashkisë. Këshilli Bashkiak ka propozuar shkarkimin, si rruga e vetme ligjërishme e mundëshme në dorën e tij me qëllim fillimin e procedurave të mëtejshme, për të rikthyer normalitetin qeverisës në Bashkinë Tiranë. Ky vullnet politik dhe ligjor i përfaqësuesve të zgjedhur të Kryeqytetit nuk mund të neglizhohet dhe Këshilli i Ministrave nuk ka asnjë alternativë tjetër, veçse të finalizojë procedurën ligjore të shkarkimit.

Ligji nr.139/2015 ka parashikuar që procedura e shkarkimit, për shkakun e përcaktuar në shkronjën "c" të nenit 62 të finalizohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ndryshe shumica e rasteve të tjera të krijimit të vakancave, të cilat kërkojnë vetëm konstatimin e faktit juridik, pas informacionit të marrë nga prefekti i qarkut përkatës.

Neni 62 kërkon vendim të Këshillit të Ministrave për tre shkaqe ligjore shkarkimi. Shkaku i parë buron nga Kushtetuta dhe i takon kompetencës së Këshillit të Ministrave që, me vullnet politik, të vendosë shkarkimin e organit të zgjedhur vendor, kur

konstaton shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve nga ana e këtij të fundit. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton në nenin 115 të saj se “organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësive qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve”. Pika 2 e këtij neni përcakton, se “organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankoher në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve, dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet”.

Kjo dispozitë e Kushtetutës nuk ka qëllim që të përcaktojë kompetencën në rastin e shkarkimit të kryetarit të bashkisë, por ka qëllim që të mbrojë pavarësinë e organeve të qeverisjes vendore nga ndërhyrjet e pushteteve të tjera, duke i dhënë kryetarit të bashkisë mbrojtje të posaçme, në rastet kur ndaj tij vepron mekanizimi i shkarkimit politik. Jo rastësisht, Kushtetuta e cila nuk lejon vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese për akte me karakter individual, në rastin e shkarkimit të kryetarit të bashkisë, që është gjithashtu akt me karakter individual, ka përcaktuar shprehimisht jo vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, por ka përcaktuar edhe pezullimin automatik të aktit, në rastin kur bëhet ankimi.

Rasti kushtetues i mësipërm është përfshirë me të njëjtin formulim edhe në shkronjën “a”, të nenit 62, të ligjit nr.139/2015, duke u përfshirë më vete në listën e shkaqeve ligjore që sjellin shkarkimin. Shkaqet e tjera të shkarkimit nga Këshilli i Ministrave vijnë për motive juridike, të cilat janë jashtë vullnetit të Këshillit të Ministrave. Në rastin e shkronjës “b” faktet juridike konfirmohen në mënyrë të pakundërshtueshme nga pushteti gjyqësor (dënim nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale). Në rastin e shkronjës “c” fakti juridik konfirmohet nga këshilli bashkiak në rrugë administrative dhe me vendimmarrje (mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë).

Diferenca me shkronjën “a” të nenit 62, qëndron në faktin, se kur ndodh shkarkimi për shkelje të rënda të Kushtetutës apo të ligjeve të tjera, mbrojtja bëhet me instrumenta kushtetuese (Gjykata Kushtetuese), kurse për rastet e tjera, palët e prekura mund të shfrytëzojnë vetëm instrumentat administrative të mbrojtjes dhe t’i ngrejë pretendimet në gjykatën kompetente administrative dhe jo sipas procedurës së posaçme që përcakton neni 115 i Kushtetutës. Po kështu, nuk zbatohet procedura e posaçme e nenit 115, të Kushtetutës edhe në rastet e tjera të mbarimit para kohe të mandatit, që përcaktohen të listuara në nenin 61, të ligjit nr.139/2025.

Kjo analizë e shkaqeve dhe mjeteve juridike ka rëndësi në kuadër të këtij projektvendimi, sepse lidhet drejtpërdrejt me qëllimin e Këshillit Bashkiak Tiranë për hapjen e rrugës për zhvillimin sa më shpejt të zgjedhjeve të pjesëshmë për kryetar bashkie në këtë bashki.

Kundërshtimi i vendimit në Gjykatën Kushtetuese nuk mund të pezullojë efektet e tij, sepse Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente për shkarkimin për shkaqe të tjera, përveç atyre të përcaktuara nga pika 1, e nenit 115, të Kushtetutës dhe shkronja “a”, e

KRYEMINISTRIA
Arkivë Protokoll
Nr. _____ prot.Dt. _____
Vërtetohet njësia me origjinalin
Nënpresin:
Mëshkrimi
Nr.fletë: _____

nenit 62, të ligjit nr.139/2015 dhe paraqitja e ankimit në Gjykatën Kushtetuese, në organin e gabuar për shqyrtimin e mjeteve ligjore të ankimit, nuk sjell efekte juridike. Po kështu, paraqitja e ankimit në gjykatën administrative kompetente nuk pezullon automatikisht efektet juridike të aktit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen organet dhe institucionet përgjegjëse.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga strukturat e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, sipas njoftimit të prefektit të Qarkut Tiranë, me shkresën nr.1273/2 prot., datë 24.9.2025, mbështetur në vendimin nr.69, datë 23.9.2025, njoftuar me shkresën nr.32642 prot., datë 24.9.2025, të kryetarit të Këshillit Bashkiak Tiranë.


Gjithashtu, është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë e cila është shprehur dakord me projektvendimin.


IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit.

MINISTËR I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

Ervin DEMO



KRYEMINISTRIA	
Arkivë Protokoli	
Nr. _____	prot.Dt. _____
Vërtetohet njësia me origjinalin	
Nëpunësi:	
(nenshkrimi)	
Nr.fletë:	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KODIFIKIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË LEGJISLACIONIT

Nr. 4690/Prot.

Tiranë, më 24.09.2025

Lënda: Kthim përgjigje për një projektvendim

MINISTRIT TË SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR


Tiranë

Për projektvendimin "Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj", të përcjellë për mendim në formë shkresore, Ministria e Drejtësisë shprehet parimisht dakord në lidhje me bazën e autorizimit ligjor, në kuptim të nenit 118 të Kushtetutës. Ndërsa sa i takon përmbajtjes konkrete të aktit, vlerësohet se ai përbën një akt me karakter individual, për të cilin Ministria e Drejtësisë nuk mund të shprehet.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

MINISTRI

Besfort Lamallari



KRYEMINISTRIA	
Arkivë Protokolli	
Nr. _____	prot.Dt. _____
Vërtetohet njëzia me origjinalin	
Nëpunësi:	
(nënshkrimi) _____	
Nr.fletë: _____	